




Frühförderung
Stadt Bern



Deutsch
lernen vor dem
Kindergarten

primano



Mësimi i gjuhës gjermane para fillimit të kopshtit

Qyteti i Bernës dëshiron që të gjithë fëmijët të kenë shanset më të mira për në shkollë. Për një fillim të suksesshëm të shkollës janë mjaft të rëndësishme njohuritë e gjuhës gjermane. Programi promovues “Mësimi i gjuhës gjermane para kopshtit” mbështet nxënësit që flasin pak ose që nuk flasin fare gjermanisht.

Si përcaktohen njohuritë e gjermanishtes së fëmijës suaj?

18 muaj para fillimit të kopshtit të fëmijës suaj, ju si prindër merrni me postë një letër ku është shënuar një lidhje e një anketimi në linjë (që disponohet në 12 gjuhë të ndryshme). Në këtë mënyrë ju mund të vlerësoni vetë njohuritë e gjermanishtes së fëmijës suaj. Anketimi trajtohet me konfidencialitet dhe vlerësohet nga Qendra e Shërbimit Shëndetësor të qytetit, promovimi i herët primano. Vlerësimi tregon nëse fëmija juaj ka nevojë për mbështetje gjuhësore në gjermanisht. Në çdo rast ju merrni komente nga ne.

Ku mund të mësojë gjermanisht fëmija juaj?

Nëse fëmija juaj ka nevojë për mbështetje gjuhësore, ai mund të frekuentojë një çerdhe apo klub lojërash deri sa të fillojë frekuentimin e kopshtit. Aty fëmija juaj mëson gjermanisht nëpërmjet lojërave. Bashkia dhe kantoni ju ndihmojnë lidhur me financimin. Kontributi i prindërve varet nga të ardhurat tuaja.

Çfarë duhet të bëni ju si prindër?

Plotësoni anketimin sipas udhëzimit të letra drejtuar prindërve. Letrën për prindërit e merrni në janar, nëse fëmija juaj e fillon kopshtin në gusht të vitit pasardhës. Ju lutem ta plotësoni anketimin edhe në ato raste kur fëmija juaj është aktualisht duke frekuentuar një çerdhe apo grup lojërash.

Dhe diçka mjaft e rëndësishme:

Gjuha e parë është e një rëndësie kryesore për formimin gjuhësor të hershëm. Si prindër ju jepni një kontribut mjaft të rëndësishëm për zhvillimin gjuhësor të fëmijës suaj, nëse flisni e luani shumë me ta në gjuhën tuaj mëmë, nëse u tregoni histori dhe u lexoni vargje dhe rima. **Kjo shërben si bazë për të gjitha gjuhët e tjera që do të mësojë fëmija juaj.**

Ku mund të gjeni informacione të mëtejshme?

www.primano.ch/deutsch-lernen



Gesundheitsdienst der Stadt Bern

Frühförderung primano
Monbijoustrasse 11, 3011 Bern
079 900 18 69